

Të dhënat për komunën e Ferizajt

Kryetar i Komunës: z. Agim Aliu

Karakteristika gjeografike dhe mbi popullsinë: Sipërfaqja e territorit **345 m²**, **108,690 banorë** (sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011), dendësia e popullsisë **315.4/km²**, lartësia mesatare mbidetare **500 m**, kodi postal **70000**.

Komuna e Ferizajt ka një pozitë të favorshme gjeografike për çasje në tregje:

-  Autostradat: Arbën Xhaferi dhe Ibrahim Rugova
-  Afërsi me aeroportet e Prishtinës, Tiranës dhe Shkupit
-  Afërsi me portin e Durrësit dhe Selanikut
-  Qendrën e skijimit në Brezovicë, dhe
-  Malet e Sharrit etj.

Ekonomia

Monedha: Euro

Sektori Financiar: Sistemi Bankar në Komunën e Ferizajt përbëhet nga 9 banka private, 7 shoqëri të sigurimeve, dy skema pensionale dhe 5 institucione mikrofinanciare.

Buxheti: Buxheti i Komunës së Ferizajt në vitin 2022 ishte **33,933,868 €**, ndërsa për vitin 2023 Buxheti i Komunës së Ferizajt është **38,103,752 €**.

Infrastruktura: Qyteti po vazhdon me ndërtimin e shkollave, kopshteve për fëmijë. Shërbimet publike janë përmirësuar ndjeshëm, të gjitha këto investime kanë ndikuar që qytetarët të ndihen më mirë në zonat ku jetojnë. Tatimet shfrytëzohen për investime në projektet të cilat përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve kudo që jetojnë.

Ferizaj është një qendër ekonomike, arsimore, kulturore dhe sportive. Komuna ka investuar shumë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Rrjedhimisht, ka shumë mundësi për aktivitete rekreative dhe argëtimi në qytet dhe zonat përreth dhe ky numër i aktiviteteve është i madh dhe duke u shtuar nga viti në vit.

Arsimi: Aktualisht Komuna e Ferizajt ka 39 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 8 shkolla të mesme të larta, me gjithsej 21,602 nxënës. Gjithashtu, në Ferizaj ndodhet Universiteti i Shkencave të Aplikuara, i cili ofron programe të ndryshme studimore brenda disa fakulteteve si: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës, Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit, Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit, Fakulteti i Menaxhmentit, dhe Fakulteti i Arteve të Aplikuara.

Lehtësirat për bizneset: Që nga viti 2019 të gjitha kategoritë e bizneseve të cilat operojnë në territorin e Komunës së Ferizajt janë të lira nga taksat komunale. Të gjitha shërbimet dhe konsultimet për bizneset e Komunës së Ferizajt ofrohen në administratën komunale, gjegjësisht në qendrën e bizneseve. Komuna me të gjithë kapacitetin e saj synon të jetë aktere kryesore e promovimit dhe zhvillimit të bizneseve, nëpërmjet krijimit të politikave të favorshme, siç mund të jenë reduktimi i procedurave burokratike, përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës, trajtimi i barabartë dhe ngritja e transparencës.

Mundësitë e investimit:

Në kuadër të masave si pjesë e pakos së lehtësirave për bizneset, Komuna e Ferizajt në vitin 2019 ka marrë vendim për heqjen e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarive afariste. Gjithashtu Komuna e Ferizajt çdo vit publikon listën e veçantë të pronave komunale që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitet vijuese në një periudhë deri në 99 vjet.

Qeverisja Komunale me të gjithë potencialin e saj është gjithnjë në shërbim të krijimit të kushteve më të mira për bizneset ekzistuese, si dhe investitorëve të interesuar në të ardhmen.



Komuna e Ferizajt

☎ 038 200 460 76

🌐 <https://ferizajbusiness.com/>

✉ info@ferizajbusiness.com



INFORMATOR PËR BIZNESET

FERIZAJ

Mjedisi i biznesit në Kosovë

Kosova është vendi më i ri evropian, me një popullsi kryesisht të re, ku mbi 70% janë nën moshën 35 vjeç. Të rinjtë e arsimuar dhe edukuar në Kosovë dhe vende të ndryshme të botës, gjithnjë e më shumë po dëshmojnë aftësitë dhe kreativitetin e tyre në ndërmarrësi. Si të tillë, gjithashtu po arrijnë të përshtaten mjediseve të reja biznesore, kryesisht si shkak i ndryshimeve dinamike që po ndodhin në ekonominë digjitale.

Kosova ndodhet në qendër të Ballkanit dhe përmes transportit ajror, rrugor dhe hekurudhor ofron çasje të lehtë në tri portet detare:

- ▶ Selaniku, Greqi: 329 km
- ▶ Durrës, Shqipëri: 262 km
- ▶ Tivar (Bar), Mali i Zi: 299 km

Zhvillimi i sektorit privat po bëhet faktorë kyç në ngritjen e ekonomisë. Për më tepër, Qeveria e Kosovës po zbaton një politikë fiskale të qëndrueshme dhe miqësore për bizneset. Ka një sërë sektorësh në Kosovë që ofrojnë mundësi të mira biznesi, ndër to janë:

-  Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
-  Minierat dhe energjia
-  Turizmi
-  Përpunimi i ushqimit
-  Përpunimi i drurit
-  Industria e përpunimit të metaleve
-  Produktet me origjinë bimore
-  Industria e ndërtimit
-  Industria e tekstilit etj.

Ekonomia

Monedha: Euro

Buxheti: Për vitin 2022 buxheti i Kosovës ishte 2.7 miliardë euro, ndërsa buxheti i vitit 2023 është 3,2 miliard euro.

Sektori Financiar: Sistemi bankar përbëhet nga 11 banka private, 14 shoqëri sigurimesh, dy skema pensionale dhe 11 institucione mikrofinanciare.

Lehtësirat në Import: Ekzistojnë lehtësira nga taksat doganore për të gjithë prodhuesit që importojnë vetë ose nëpërmjet kontraktorëve në disa fusha, siç janë: lënda e parë, e cila përdoret në prodhim, gjysmëfabrikat e përdorura në prodhim, makineritë e prodhimit, dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit.

Tregtia e lirë: Që nga viti 2007 Kosova është pjesë e CEFTA-s, ndërsa në tetor të vitit 2015 ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE). Përmes kësaj marrëveshje, Kosova ofron çasje të lirë në tregun e BE-së dhe kosto të ulët të punës në krahasim me Evropën Qendrore dhe Lindore, por edhe në krahasim me vendet fqinje.

Mjedisi biznesor: Përparësitë e krijuara, siç janë sistemi i favorshëm i politikave fiskale, potencialet natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja, si dhe përparësi të tjera e bëjnë Kosovën një mjedis atraktiv dhe të favorshëm për investitorët e huaj. Shumë kompani që kërkojnë furnizues të mundshëm ose për të afruar prodhimin më pranë vendeve anëtare të BE-së janë kthyer në Ballkanin Perëndimor.

Arsimi: Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë po reformohet në vazhdimësi duke i dhënë rëndësi të madhe cilësisë. Aktualisht Kosova ka gjashtë universitete shtetërore dhe disa universitete dhe kolegje private.

Mjedisi i biznesit në Komunën e Ferizajt

Sa i përket sipërfaqes, numrit të popullsisë, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore, Ferizaj është një ndër qendrat kryesore në pjesën jugore të Kosovës. Ferizaj është vendi ku ofrohet një numër i madh i shërbimeve, gjegjësisht ku zhvillohen aktivitete të ndryshme biznesore, të cilat janë të lidhura jo vetëm me qytetin, por edhe me pjesët e tjera të rajonit. Këtu përfshihen:

- Shërbimet publike dhe administrative (Universiteti, Spitali Rajonal, Gjykatat etj);
- Aktivitetet ekonomike (aktivitete industriale dhe të shitjes me shumicë, bankat, aktivitete të tjera të bizneseve të vogla dhe të mesme);
- Institucionet kulturore (muzeu, galeria);
- disa aktivitete dhe ekspozita rajonale (karnevali, festivale të ndryshme tradicionale etj.).

Zhvillim i komunës së Ferizajt si një qendër rajonale bazohet në tri shtylla kryesore:

- ▶ Si një qendër e zhvillimit ekonomik rajonal,
- ▶ Si një qendër e zhvillimit të turizmit, dhe
- ▶ Si një qendër arsimore dhe administrative.